



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**BURSA E KOLEGJIT TË EVROPËS
KAMPUSI NATOLIN
VITI AKADEMIK 2022-2023**

Ministria e Punëve të Jashtme e Polonisë njofton mbi bursat e Kolegjit të Evropës, kampusit Natolin, Poloni, të vlefshme për studentët e Ballkanit Perëndimor, për vitin akademik 2022-2023. Afati për të aplikuar për këtë bursë është deri më **19 janar 2022**.

Kjo bursë përfshin programin e studimeve ndërdisiplinore evropiane, i cili pasqyron natyrën gjithnjë e më komplekse dhe të ndërlidhur të integritit evropian dhe të botës përreth, duke trajtuar dimensionin e brendshëm dhe të jashtëm të Bashkimit Evropian, me fokus të veçantë në fqinjësinë e BE-së, historinë dhe qytetërimin evropian, duke u ofruar studentëve një perspektivë më të gjerë për Evropën. Studimet në kampusin Natolin, kombinojnë një përgatitje të plotë akademike, kurse gjuhësore dhe një program aftësish profesionale që më vonë u mundësojnë të diplomuarve të japin një kontribut thelbësor në çështjet evropiane, qoftë përmes punës në administrata kombëtare, diplomaci, institucionet evropiane, organizatat ndërkombëtare apo OJQ-të, por edhe në sektorin privat dhe akademik.

Vendndodhja e kampusit Natolin në Poloni, një vend afër kufirit lindor të Bashkimit Evropian, e bën atë një pikënisje ideale për eksplorimin e ndikimit politik dhe socio-ekonomik të BE-së në Evropën Qendrore dhe Lindore. Udhëtimet studimore në vendet e BE-së ofrojnë një mundësi unike për të përvetësuar, vlerësuar dhe ballafaquar njohuritë në lidhje me një zonë të caktuar gjeografike përmes prizmit të ndikimit që procesi i integritit në BE dhe marrëdhëniet e jashtme të BE-së kanë. Udhëtimet studimore janë krijuar për t'u ofruar studentëve informacion, takime, leksione dhe përvoja të tjera akademike, të cilat nuk mund të ofrohen me mjete tradicionale në kampus. Në këtë aspekt ato përfaqësojnë një vlerë të shtuar të pazëvendësueshme për programin akademik.

Aplikimet duhet të bëhen në adresën: <https://admissions.coleurope.eu/login>

Për më shumë informacion në kuadër të kësaj burse apo pyetje, mund t'i shkruani adresës:
communications.pl@coleurope.eu

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE
ASISTENCËS**